



MM - 420 MATIMOR



PAKETIMI

25 kg



RAPORTI I PERZIERJES

5-6 L / 25kg



KONSUMI

1.5 kg/m²

Përkufizimi i Produktit

MM-420 MATIMOR është një llaç mbushës themelor, i përmirësuar me aditivë special, që mund të aplikohet me dorë ose me makineri.

Veçoritë

- Ka fuqi të lartë ngjitëse dhe qëndrueshmëri, nuk rrëshqet.
- Ka rezistencë të lartë mekanike.
- Rezistent ndaj cikleve të ngrirje-shkrirjes.
- Mund të aplikohet në trashësi prej 2,5 cm.
- Kursen kohë dhe punë.
- Lehtësisht i punueshëm.

Përgatitja e Sipërfaqes

- Sipërfaqja duhet të jetë e thatë, e pastër dhe e qëndrueshme.
- Sipërfaqet që do të mbushen duhet të jenë të pastra nga substancat që pengojnë ngjitjen, të tilla si pluhuri, papastërtitë, myku, vajrat, boja, etj.
- Llaçi mbushës nuk duhet përdorur në sipërfaqe të ngrira ose të shkrira ose sipërfaqe që rrezikojnë të ngrijnë brenda 24 orëve.

Udhëzime për përdorimin e Produktit

- Zbrazni me ngadalë 25 kg MM-420 MATIMOR në sasinë e rekomanduar të ujit dhe përziejeni derisa të përftohet një masë homogjene. Përzierja duhet bërë me një mikser me xhiro të ulëta. Mos shtoni asnjë aditiv (lëndë shtesë) që nuk është i shkruar në udhëzimin e përdorimit të produktit.
- Llaçi i përgatitur duhet të pushojë për 5-10 minuta që të bëhet gati për përdorim. Duhet përzierë sërish 1-2 minuta përpara se të aplikohet.
- MM-420 MATIMOR duhet aplikuar me një mallë çeliku dhe çdo shtresë nuk duhet të jetë më e trashë se 25mm. Për aplikime më të mëdha se 25mm, dora e dytë duhet bërë pas të paktën një ditë.

Mbrojtja pas Aplikimit & Sugjerime

- Pas aplikimit, sipërfaqja duhet lagur në periudha të caktuara gjatë tharjes, nëse është e nevojshme.
- Aplikimi i radhës duhet bërë pasi të jetë forcuar/tharë plotësisht shtresa e parë.
- Llaçi i përgatitur duhet përdorur brenda 3 orëve. Llaçi i skaduar apo që ka zënë cipë në enë duhet hedhur. Kushtet e motit si temperatura e lartë, lagështia e ulët ose era mund ta shkurtojnë kohën e përdorimit.
- Pas aplikimit, duart dhe mjetet e punës duhen larë me ujë të bollshëm.
- Konsumi i treguar është informacion i përgjithshëm. Mund të ndryshojë në varësi të kushteve të aplikimit dhe veçorive të sipërfaqes.
- Përmban çimento, ndaj është irritues për sytë, sistemin e frymëmarrjes dhe lëkurën. Për më shumë informacione, referojuni fletës së të dhënave të sigurisë.

Magazinimi

- Produkti duhet ruajtur në ambient të thatë dhe të freskët, në temperature midis +5°C dhe +35°C, në kushte jo të lagështa dhe duke shmangur dritën direkte të diellit.
- Produkti duhet mbrojtur nga uji, ngrica dhe kushtet jo të favorshme të motit.
- Mund të vendosen deri në 3 paleta njëra mbi tjetrën.
- Jetëgjatësia është maksimalisht 12 muaj në kushtet e përshkruara më sipër për ruajtjen dhe magazinimin.

SKEDA TEKNIKE (NË +23°C DHE 50% U.R.)

Forma	Pluhur
Ngjyra	Gri
Magazinimi	12 muaj nëse ruhet në paketimin original të mbyllur, në një vend të thatë.
Raporti i përzierjes	5-6 litra ujë / 25 kilogram
Temperatura e aplikimit	(+5°C) - (+35°C)
Trashësia maksimale për dorë	25 mm
Kohëzgjatja e përzierjes	3-4 orë
Reaksioni ndaj zjarrit	A1
Substanca të rrezikshme	Shiko SDS